



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 12

Datë: 03. 04. 2019. Ora: 13:00

Vendi: Selia e KQZ-së/Prishtinë.

Kryesuese e mbledhjes: Valdete Daka, kryetare e KQZ.

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Sami Hamiti, Adnan Rustemi, Nazlije Bala, Ercan Spat, Alfred Kinolli, Čemailj Kurtišti.

SKQZ: Enis Halimi, Kryeshef i SKQZ.

Përkthyes: Vera Dula. **Procesmbajtës:** Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

- 1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;**
-Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së KQZ-së nr. 10/2019.
- 2. Aktivitetet e Sekretariatit të KQZ-së:**
- 3. Raporti i Këshillave të KQZ-së:**
 - **Këshilli për Çështje Ligjore:**
 - Shqyrtimi dhe miratimi i zëvendësimit të anëtarit të kuvendit komunal në Mitrovicën e Jugut;
 - **Këshilli për Operacione Zgjedhore:**
 - Shqyrtimi dhe miratimi i Rekomandimit për miratimin e dizajnit përmbajtjes dhe formatit të fletëvotimeve;
 - Shqyrtimi dhe miratimi i Rekomandimit për rritjen e numrit të votuesve për vendvotime;
 - Shqyrtimi dhe miratimi i anëtarëve të Këshillave të Vendvotimeve,
- 4. Të ndryshme.**

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së KQZ-së nr. 10/2019.

Valdete Daka: Mirë se keni ardh, a ka dikush ndonjë vërejtje, ndonjë propozim...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan rendin e ditës. Pas miratimit të rendit të ditës, anëtarë e KQZ-së, shqyrtuan procesverbalin nga mbledhja e KQZ-së nr. 10/2019. Adnan Rrustemi, kërkoi që në fund të procesverbalit të evidentohet fakti që vendimi për certifikim, vendimi i PZAP-së, nuk është votuar në KQZ... Të përmirësohet paragrafi ku flitet për këtë...

Pas kësaj vërejtje, anëtarët e KQZ-së miratuan procesverbalin nr. 10/2019.

2. Aktivitetet e Sekretariatit të KQZ-së:

Enis Halimi: Sekretariati, ka vazhduar me aktivitetet e veta. Periudha e shërbimit votues, për sa i takon ndërrimit të qendrave të votimit, tashmë ka përfunduar më datën 29 prill, dhe i kemi pasur diku 19 kërkesa të prashtrueme për ndërrim të QV-e: 15 kanë qenë aplikacionit, dhe 4 në zyrën e KKZ-së...

Për sa i takon votimit jashtë Kosovës, është periudhë që ka përfunduar më datën 30 prill, dhe se gjatë kësaj periudhe kemi pranuar 1056 aplikacione përmes postës, dhe 2 aplikacione përmes imellit...Pas verifikimit të zotësisë juridike, janë aprovuar 793 aplikacione, dhe janë refuzuar 263 aplikacione për arsye të mos përmbushjes së kriterëve ligjore...

Periudha e sfidimit dhe e kundërshtimit, do të filloj sot, dhe Sekretariati i ka bërë të gjitha përgatitjet: ka bërë shpërndarjen e materialeve, sikur kërkohet...Sa i përket informimit dhe edukimit të votuesve, kanë pasuar të gjitha fazat dhe janë në realizim e sipër...Është mbajtur edhe takimi i sigurisë, dhe ai me prokurorinë me qëllim të garantimit të procesit... Edhe në QNR, janë duke u bërë përgatitjet e nevojshme...

3. Raporti i Këshillave të KQZ-së

1.Këshilli për Cështje Ligjore:

Shqyrtimi dhe miratimi i zëvendësimit të anëtarit të kuvendit komunal në Mitrovicën e Jugut:

Çemailj Kurtišti: Përshëndetje, e kemi përfunduar analizimin dhe shqyrtimin, dhe në këshill sipas dokumentacionit dhe legjislacionit, kemi bërë zëvendësimin e anëtarit për asamble komunale. Gjithçka është në rregull, dhe ne i rekomandojmë KQZ-së zëvendësimin e anëtarit nga radhët e Lëvizjes “VETËVENDOSJE!”...

Valdete Daka: Atëherë, kush është për rekomandimin e KCL-së që, Shkëndije Halimi të emërohet anëtare e Kuvendit Komunal në Mitrovicën e Jugut, duke e zëvendësuar anëtarin e deritashme të këtij kuvendi, Vlora Haxhimehmedi.

Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë zëvendësim.

2. Këshilli për Operacione Zgjedhore:

Adnan Rrustemi: KOZ në mbledhjen e fundit, ka shqyrtuar dy pika të rendit të ditës:
1. Shqyrtimi dhe miratimi i Rekomandimit për miratimin e dizajnit përmbajtjes dhe

formatit të fletëvotimeve. 2. Shqyrtimi dhe miratimi i Rekomandimit për rritjen e numrit të votuesve për vendvotime.

E keni propozim vendimin që bazohet në ligjin për zgjedhjet....Po shpërndahe edhe dizajni nga KQZ...Dhe, ne rekomandojmë të aprovohe.

Valdete Daka: Pse është formati A/4...?

Adnan Rrustemi: Janë vetëm tre kandidatë, mbase më i përshtatshëm...

Pas shqyrtimit, anëtarët e KQZ-së aprovan dizajnin dhe formatin e fletëvotimeve.

Adnan Rrustemi: Gjithashtu, kemi shqyrtuar vendimin për rritjen e numrit maksimal të votuesve për çdo vendvotim. Nga 750 votues që e parashih ligji, rekomandojmë KQZ-në që ta marrë një vendim për rritjen e numrit...Kjo, nuk reflekton ndonjë pengesë, megjithëse nuk mund ta tejkalojmë tavanin – numrin mbi 950...Ndërkaq, sipas analizës së Sekretariatit, nëse ne aprovojmë vendvotimet me 750 votues, do të kemi 104 vendvotime, e nëse aprovojmë vendvotimet me 950 votues, do të kemi 87 vendvotime...

Nuk është diçka e re, rekomandojmë rritjen në 950 votues...

Valdete Daka: Nuk e analizuar vërejtjen e Stevanit lidhur me madhësinë e logos së partisë...

Enis Halimi: Formatin është e njëjtë, simetria e logos së partisë është e njëjtë, por teknikisht mund të realizohet...

Sami Hamiti: Mund të rregullohet teknikisht

Stevan Veselinoviq: Në princip, proporcioni le të mbetet e këtillë, vetëm të rregullohet në aspekt të lartësisë...

Në fund të shqyrtimit, anëtarët e KQZ-së miratuan rritjen e numrit të votuesve në vendvotime: në 950 votues...